



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH.nr. 682/19

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të : z. Nuhi Paçarizi– Kryetar, z. Blerim Dina - Referues, z. Goran Milenkovic – Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga Operatori Ekonomik: NPN “UNI PROJECT”- Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë grupi i OE-ve: „Efa Dienstleistung GmbH & N.SH.H. Zona Park Eurofamis Sh.a” lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Pastrimi i objekteve të Komunës së Prishtinës” me nr. prokurimit: 616-19-3012-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- “K K Prishtinë”, më datën 01.11.2019, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, si pjesërisht e bazuar ankesa Operatorit Ekonomik: NPN “UNI PROJECT”- Prishtinë , lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Pastrimi i objekteve të Komunës së Prishtinës” me nr. prokurimit: 616-19-3012-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- “Kuvendi Komunal Prishtinë”.

II. VËRTETOHET, njoftimi për dhënie të kontratës i autoritetit kontraktues “Kuvendi Komunal Prishtinë”, lidhur me aktivitetin të prokurimit me titull “Pastrimi i objekteve të Komunës së Prishtinës” me nr. prokurimit: 616-19-3012-2-1-1.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues: NPN “UNI PROJECT”- Prishtinë, aprovohet si pjesërisht e bazuar, të njëjtit i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Data e Njoftimi për kontratë është bërë me dt: 16.05.2019.

Afati i fundit për dorëzimin e ofertave është bërë me dt: 15.07.2019.

Data e njoftimit me letrën standarde për tenderues me dt: 30.09.2019.

Data e kërkeses për rishqyrtim me dt: 03.10.2019.

Data e vendimit nga AK-së lidhur me kërkesën për rishqyrtim me dt: 04.10.2019.

Operatori Ekonomik: NPN “UNI PROJECT”- Prishtinë, si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP, me 11.10.2019 me nr. 682/19, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Pastrimi i objekteve të Komunës së Prishtinës” me nr. prokurimit: 616-19-3012-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- Kuvendi Komunal Prishtinë”, duke pretenduar se janë shkelur dispozitat.

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 6,7,59,60, dhe 72 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës dhe nenin 39,41 të RROUP.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 13.06.2019 ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 21.10.2019, Lidhur me pretendimin e OE ankues, se AK ka bërë shkelje të nenit 6, 7, 59, 60 dhe 72 të LPP-së si dhe nenet 39 dhe 41 të RRUOPP me rastin e refuzimit të tenderin tone me arsyetimin:

“Me datë 30.09.2019 përmes letrës standarde dhe vendimit të AK jemi njoftuar nga Komuna e Prishtinës

se jemi anuluar nga aktiviteti i prokurimit me arsyetimin si me poshtë:

Kërkesa ne dosje OE duhet te dëshmoj se posedon listën e pajisjeve me poshtë te cekur a. 1(një) Automjet me shportë speciale për punë:

b. 1(një) Pikap c.2(dy) Frezë dore për largimin e bores d.1(një)Makinë për larjen e pllakave e.1(një)Makinë për thithjen e ujit f. 5(Pesë) Trimerë për kositje g.3(tre) Kositëse bari”.

Arsyetimi i dhënë nga AK Ndërsa ne kemi dorëzuar listën qe kemi ofertuar me 3 trimera për kositje, i cili konstatim nuk qëndron.

Ne këtë rast duke na eliminuar padrejtësisht për arsyet e lartcekura autoriteti ka shkelur dispozitat ligjore-te cekura me larte. Me eliminimin e ofertës sonë si ofertë me çmim dukshëm me te lirë se OE i shpërblyer me kontratë për arsye te pa bazuara paraqet shkelje te rendë te LPP_se dhe dëmtim te buxhetit te Kosovës ku vetëm ne këtë rast buxheti është dëmtuar për 232,974.00 € 'Përveç LPP-se dëmtimi i tillë i buxhetit po ashtu paraqet vepër penale duke shkelur kodin penal te Republikës se Kosovës dhe shpërdorim te detyrës zyrtare.” duke u bazuar në faktet e gjetura me rastin e trajtimit te lendes eksperti shqyrtues konstaton se pretendimet e operatorit ekonomik ankues nuk janë të bazuara sepse OE ankuese nuk i ka dorëzuar dëshmitë konform kërkesave të parashtruara nga AK respektivisht OE ankues se bashku me dosjen e tenderit ka bashkangjitur “Deklarata për mjetet e punës” te datës 27.06.2019, ne te cilën deklarate ne numrin rendor 2(dy) ka specifikuar “Trimera për kositje bari, copë 3”, dhe të njëjtës listë i janë bashkangjitur disa DUD doganor si dhe një mori faturash të mjeteve dhe mallrave që posedon operatori ekonomik, ndërsa nga AK në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë ka parashtruar kërkesën dhe dëshminë si vijon:

Kërkesa: OE duhet te dëshmoj se posedon listën e pajisjeve me poshtë te cekur a.1(një) Automjet me shportë speciale për punë b. 1(një) Pikap c. 2 (dy) Frezë dore për largimin e bores d. 1 (një) Makinë për larjen e pllakave e. 1 (një) Makinë për thithjen e ujit f. 5 (Pesë) Trimerë për kositje g. 3 (tre) Kositëse bari. Dëshmia: Dëshmi mbi pronësinë (apo te marrjes me qira) te mjeteve, kopjet e Librezave te qarkullimit me validitet për automjetet qe regjistrohen apo DUD doganor fature për blerje për pajisjet qe nuk regjistrohen.

Bazuar në dëshmitë e lartcekura eksperti shqyrtues konstaton se operatori ekonomik ankues nuk ka specifikuar në listën e mjeteve te punës dhe nuk ka dorëzuar dëshmi të mjaftueshme se posedon 5(pesë) Trimerë për kositje ashtu siç ka kërkuar AK në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë.

Gjithashtu eksperti shqyrtues konstaton se OE ankuese ka dorëzuar ofertën më të lirë, se sa oferta e operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë mirëpo AK është e obliguar të zbatoj nenin 60 te LPP-së përkatësisht kriterin e përcaktuar ne paragrafin 1.1, si ne vijim:”AK do ti a jap kontratën publike OE i cili e ka dorëzuar tenderin e përgjegjshëm me çmim më te ulet”.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa me nr. 682/19 dt. 11.10.2019 e OE "NPN Uni Project"-Prishtinë., të hidhet poshtë si e pa bazuar (për arsyeje që u ceken tek përgjigjet në pretendimet e ankesës), si dhe rekomandon që njoftimi për dhënie të kontratës i AK-së të mbetet në fuqi.

Operatori Ekonomik , përmes parashtresës me shkrim të datës: 23.10.2019, ka njoftuar Panelin shqyrtues se nuk pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Autoriteti Kontraktues , përmes parashtresës me shkrim të datës: 22.10.2019, ka njoftuar Panelin shqyrtues se pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 01.11.2019, ku kanë qenë prezent paneli shqyrtues, përfaqësuesi i OE ankues. Përfaqësuesi i AK-së si dhe eksperti shqyrtues i OSHP-së, u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për dhënie të kontratë, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesja e OE-së znj. Bllaca deklaroj: Qëndrojmë ne tërësi pran ankese sonë, Te gjitha pretendimet tona i kemi dhënë ne ankese ashtu qe pas shqyrtimit te raportit te ekspertit ne nuk pajtohemi me mendimin e tij dh mendojmë qe pretendimet tona ankimore nuk janë shqyrtuar ne mënyrë profesionale prandaj paneli shqyrtues ti ketë parasysh pretendimet tona.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesja e AK-së znj. Dalipi deklaroj: Autoriteti Kontraktues pajtohet ne tërësi me raportin e E.Sh. OE ankues ne ofertën e tij ne listën e vet dorëzuar ka deklaruar se i ka 3 Trimerat për kositje te barit ndërsa Kërkesë e Autoritetit Kontraktues ka qenë 5.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesja e OE-së znj. Bllaca deklaroj: Kërkojmë nga paneli shqyrtues te aprovoj ankesën tone si te bazuar dhe lënda te kthehet ne rivlerësim.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesja e AK-së znj. Dalipi deklaroj: Kërkojmë nga paneli shqyrtues te hedhe poshtë ankesën e OE si te pa bazuar dhe te mbetet ne fuqi vendimi i Autoritetit Kontraktues

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues deklarimit të

palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron se ankesa është parashtruar kundër njoftimit për dhënie të kontratës.

Lidhur me pretendimin e OE ankues, se AK ka bërë shkelje të nenit 6, 7, 59, 60 dhe 72 të LPP-së si dhe nenet 39 dhe 41 të RRUOPP me rastin e refuzimit të tenderin tone me arsyetimin:

“Me datë 30.09.2019 përmes letrës standarde dhe vendimit të AK jemi njoftuar nga Komuna e Prishtinës se jemi anuluar nga aktiviteti i prokurimit me arsyetimin si me poshtë:

Kërkesa në dosje OE duhet të dëshmojë se posedon listën e pajisjeve me poshtë të cekur a. 1(një) Automjet me shportë speciale për punë:

b. 1(një) Pikap c.2(dy) Frezë dore për largimin e bores d.1(një)Makinë për larjen e pllakave e.1(një)Makinë për thithjen e ujit f. 5(Pesë) Trimerë për kositje g.3(tre) Kositëse bari”.

Arsyetimi i dhënë nga AK Ndërsa ne kemi dorëzuar listën që kemi ofertuar me 3 trimera për kositje, i cili konstatim nuk qëndron.

Ne këtë rast duke na eliminuar padrejtësisht për arsye të lartcekura autoriteti ka shkelur dispozitat ligjore të cekura më lartë. Me eliminimin e ofertës sonë si ofertë me çmim dukshëm më të lirë se OE i shpërblyer me kontratë për arsye të pa bazuara paraqet shkelje të rëndë të LPP-se dhe dëmtim të buxhetit të Kosovës ku vetëm në këtë rast buxheti është dëmtuar për 232,974.00 € 'Përveç LPP-se dëmtimi i tillë i buxhetit po ashtu paraqet vepër penale duke shkelur kodin penal të Republikës së Kosovës dhe shpërdorim të detyrës zyrtare.”

Paneli shqyrtues konform ekspertitit shqyrtues profesional konstaton se pretendimet e operatorit ekonomik ankues nuk janë të bazuara sepse OE ankuese nuk i ka dorëzuar dëshmitë konform kërkesave të parashtruara nga AK respektivisht OE ankues se bashku me dosjen e tenderit ka bashkangjitur “Deklarata për mjetet e punës” të datës 27.06.2019, në të cilën deklaratë në numrin rendor 2(dy) ka specifikuar “Trimerë për kositje bari, copë 3”, dhe të njëjtës listë i janë bashkangjitur disa DUD doganor si dhe një mori faturash të mjeteve dhe mallrave që posedon operatori ekonomik, ndërsa nga AK në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë ka parashtruar kërkesën dhe dëshminë si vijon:

Kërkesa: OE duhet të dëshmojë se posedon listën e pajisjeve me poshtë të cekur a.1(një) Automjet me shportë speciale për punë b. 1(një) Pikap c. 2 (dy) Frezë dore për largimin e bores d. 1 (një) Makinë për larjen e pllakave e. 1 (një) Makinë për thithjen e ujit f. 5 (Pesë) Trimerë për kositje g. 3 (tre) Kositëse bari.

Dëshmia: Dëshmi mbi pronësinë (apo të marrjes me qira) të mjeteve, kopjet e Librezave të qarkullimit me validitet për automjetet që regjistrohen apo DUD doganor fature për blerje për pajisjet që nuk regjistrohen.

Andaj duke u bazuar ne faktet e prezantuara si me lart paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues profesional konstaton se operatori ekonomik ankues nuk ka specifikuar në listën e mjeteve te punës dhe nuk ka dorëzuar dëshmi të mjaftueshme se posedon 5(pesë) Trimerë për kositje ashtu siç ka kërkuar AK në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë.

Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues profesional konstaton se pavarësisht faktit se OE ankues ka ofertuar me çmim më te lire se sa OE i rekomanduar për dhënie te kontratës, i njëjti nuk ka plotësuar kërkesat e dosjes se tenderit dhe njoftimit për kontrate, andaj si i tillë nuk mund te shpërblehet me kontrate vetëm se OE ankues ka dhen çmim me te ulet, kjo për faktin se konform nenit 60 paragrafi 1.1 të LPP-së, AK do ti a jap kontratën publike OE i cili e ka dorëzuar tenderin e përgjegjshëm me çmim më te ulet”, pra nga te cekurat si me lart konstatohet se për tu shpërblyer me kontrate OE duhet paraprakisht te jetë i përgjegjshëm në bazë te kërkesave te DT dhe njeherit të ofertoj edhe me çmim më të lirë se të gjithë ofertuesit tjerë të përgjegjësesh.

Paneli shqyrtues konstaton se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së dhe njëkohësisht është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës, e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët, konform nenit 60 të LPP-së.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesë padi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues
Nuhi PAÇARIZI



Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK – “Kuvendi Komunal Prishtinë”
- 1x1 OE- NPN “UNI PROJECT”- Prishtinë,
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së.